



Pranuar / Dorezuar Prijemeno/Prilato Received/Delivery	20.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMSICK	5511/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.762/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.762/2022 të datës 02.09.2022 të parashtruar nga ankuesi nga Prishtina me adresë banimi indër Vendimit me numër Ref.003/0-1/KPMM të datës 09.08.2022 të Kryesueses së Sektorit të Personelit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 20.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.762/2022 e datës 02.09.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. *Anulohet në tërësi* procedura lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009378 për pozitën e punës "Drejtor i Departamentit Ligjor", e shpallur më datë 05.07.2022 nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.
- III. *Obligohet* Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 02.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5106/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit

me numër Ref.003/0-1/KPMM të datës 09.08.2022 të Kryesueses së Sektorit të Personelit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të organi i punësimit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Ndërsa, Këshilli më datë 12.09.2022 ka pranuar shkresat lidhur çështjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 5106/2022 të datës 02.09.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me Nr. Referencë: RN00009378 për lëvizje brenda kategorisë për Drejtor të Departamentit Ligjor; Aplikacionin e ankuesit me dokumentet e bashkangjitura: Akt Emërimit e datës 29.12.2011; CV-në; Diplomën me Nr.552/1018 e datës 03.10.2018; Certifikatën me Nr.K-57/99-08/624 e datës 11.12.2006; Vendimin me Nr. 66/2022 të datës 10.05.2022; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.Ref:MPJ-DA-005/2 e datës 26.01.2009; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.Ref:MPJ-DA-005/2 e datës 01.09.2009; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.Ref:MPJ-DA-005/2 e datës 31.08.2011; Certifikatën e trajnimit e datës 31.03.2011; Certifikatën nga The Cambridge School e datës 08.12.2009; Certifikatën e trajnimit për periudhën 06-08.11.2008; Vërtetimin me Nr. 384/07 të datës 12.09.2007; Certifikatën nga London School of English për periudhën 06.03-28.06.2007; Certifikatën e trajnimit e për periudhën 08-08.05.2009; Formularin për vlerësimin për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2020 i datës 22.10.2020; Formularin për vlerësimin për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2021 i datës 29.10.2021; Vërtetimin e marrëdhënies së punës me Nr. 214/2022 i datës 26.07.2022; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan Dega në Viti e datës 25.07.2022; Vendimin me numër Ref.003/0-1/KPMM i datës 01.08.2022; e-mailin e datës 04.08.2022 nga ankuesi; e-mailin e datës 01.08.2022 për ankuesin nga Ankesën e datës 03.08.2022 nga ankuesi; Vendimin me numër Ref.003/0-1/KPMM i datës 09.08.2022; e-mailin e datës 09.08.2022 nga ankuesi për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.09.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 12.09.2022; Aplikacionin e ankuesit me dokumentet e bashkangjitura; Njoftimin e datës 15.08.2022 për përfundimin e procedurës së vlerësimit paraprak; Lista e kandidatëve të refuzuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së është e bazuar ankesa e ankuesit, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale rezulton së Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale më datë 05.07.2022 ka shpallur Konkursin më numër reference RN00009378 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën " *Drejtor i Departamentit Ligjor*", klasa drejtues i mesëm 1, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Në fazën e verifikimit paraprak, me Vendimin me numër Ref.003/0-1/KPMM të datës 01.08.2022 të Kryesueses së Sektorit të Personelit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin që nuk mban pozitë të kategorisë së njëjtë në të cilën është shpall konkursi. Kundër këtij vendimi, ankuesi më datë 03.08.2022 ka parashtruar ankesë pranë Sektorit të Personelit të Komisionit të

Pavarur për Miniera dhe Minerale, ndërsa me Vendimin më numër Ref.003/0-1/KPMM të datës 09.08.2022 të Kryesueses së Sektorit të Personelit është refuzuar ankesa e ankuesit po me arsyetimin se i njëjti nuk plotëson kushtet për këtë pozitë meqenëse nuk është i punësuar në kategorinë e njëjtë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Vendimi më numër Ref.003/0-1/KPMM i datës 09.08.2022 të Kryesueses së Sektorit të Personelit është nxjerr si rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit sepse i njëjti ka plotësuar kushtet e konkursit. Me tej shton së kriteret e këtij konkursi janë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil respektivisht në kundërshtim me përshkrimin e përgjithshëm për drejtues të mesëm 1, sepse tek përvoja e punës kërkohet së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese.

Në kuptim të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore lidhur me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, përkatësisht :

Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, neni 33 paragrafi 2 ka përcaktuar se: *"Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë"*, neni 38 me të cilin është përcaktuar se: *"Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nënparagrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji...."*

Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht nenin 40 ku thuhet se: *"..2. Lëvizja brenda kategorisë është procedurë konkurruese. Konkurrimi organizohet për secilën pozitë të lirë. 3. Konkurrimi për lëvizjen brenda kategorisë është e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil..., nenin 41 ku parashihet se: 1. Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit. 2. Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurrim për lëvizjen brenda kategorisë"* dhe nenin 45 ku theksohet se" 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse

kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ.

Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil konkretisht, Neni 4 përcakton se: "Kategoritë e pozitive në shërbimin civil 1. Në pajtim me Ligjin, pozitën e punës në shërbimin civil të Kosovës ndahen në këto kategori funksionale: 1.1. Kategoria e Lartë Drejtuese; 1.2. Kategoria e Mesme Drejtuese; 1.3. Kategoria e Ulët Drejtuese, dhe 1.4. Kategoria Profesionale. Neni 11 parasheh se: Klasat përbërëse të kategorisë të Mesme Drejtuese, dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë:" Drejtues i Mesëm 1 1. Drejtor Departamenti në Presidencë; 2. Drejtor Departamenti në Zyrën e Kryeministrit; 3. Drejtor Departamenti në një Ministri; 4. Drejtor Departamenti në një institucion kushtetues të pavarura; 5. Drejtor i Departamentit në Agjenci të Pavarur dhe në Agjenci Rregullatore.

Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158 , Neni 55 paragrafi 1 me të cilin asht përcaktuar statusi ligjor i KPMM-së ku shprehimisht thuhet se" Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale përcaktohet si agjenci e pavarur në përputhje me nenin 119 paragrafi 5. dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nga hyrja në fuqi e këtij ligji do të veprojë në përputhje me këtë ligj dhe në bazë të këtij ligji...".

Andaj, në vështrim të dispozitave ligjore si me lartë si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit vlerëson se organi i punësimit me të drejtë ka refuzuar aplikacionin e ankuesit pasi që i njëjti sipas dëshmive të ofruara ushtron pozitën Auditor i Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e cila pozitë nuk është pozitë e kategorisë së njëjtë me pozitën e Drejtorit të Departamentit në kuptim të nenit 33 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Mirëpo, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i prova të administruara ka gjetur së kriteret e Konkursit me numër reference RN00009378 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor, janë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, gjegjësisht sipas konkursit në fjalë si kërkesa të përgjithshme formale janë kërkuar: **Arsimi:** *Diplome të studimeve universitare në Fakultetin Juridik me të paktën 240 kredi /ECTS (sistem 4 vjeçar) apo Diplomë Bachelor të studimeve universitare në Fakultetin Juridik me 180 kredi/ECTS (sistemi 3 vjeçar) me kusht që të ketë të përfunduar studimet Master në Fakultetin Juridik...përvoja e punës: Së paku 5 vite përvojë pune profesionale juridike, me të paktën 3 vite përvojë punë në fushën e sektorit të minierave ose/apo energjisë",* ndërsa bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil konkretisht Shtojcën Nr.1/4: për klasën Drejtues i Mesëm 1 si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **a) Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë/a të studimeve me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. b) Kualifikime të posaçme formale:* *Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese, rrjedhimisht bazuar në këto fakte rezulton se kriteri lidhur me përvojën e punës nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara me dispozitat ligjore si me lart, kështu që Kolegji konstaton së është i bazuar pretendimi mbi këtë bazë ankimore.*

Nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji duke u bazuar në Nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton së një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedurë e

paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të Nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.762/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit .
- Drejtorit të Përgjithshëm të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

